

GRUPI RAIFFEISEN BANK INTERNATIONAL

KODI I MIRËSJELLJES për FURNITORËT

(në tekstin e mëtejshëm "KiM")

HYRJE

Bazuar në vlerat thelbësore të RBI që adresojnë etikën e biznesit, angazhimet shoqërore dhe mjedisore, RBI kërkon që furnitorët e saj t'i përmbahen parimeve të listuara në vazhdim (siç janë definuar më poshtë), të cilat do të aplikohen për çdo kontratë të lidhur ndërmjet tyre ("Kontrata"). KiM vlen për të gjithë furnitorët e RBI-së që liferojnë mallra, shërbime ose licenca për ose në emër të ndonjë prej njësive biznesore dhe filialeve të RBI-së. Furnitori bën gjithçka për t'i implementuar këto parime në të gjithë zinxhirin e tij të furnizimit. Ky KiM nuk ka për qëllim t'i zëvendësojë ligjet dhe rregulloret në fuqi në asnjë vend ku operon RBI. Ai synon inkurajimin dhe respektimin e këtyre ligjeve dhe rregulloreve dhe siguron që ato të zbatohen me besnikëri dhe në mënyrë efektive. Furnitori bashkëvepron me ndershmëri, transparencë dhe vlerësim të ndërsjellë me Grupin RBI dhe përfaqësuesit e tij.

KiM është dygjuhësh, me versionin në gjuhën angleze si kryesorin.

PARIMET

1. Sanksionet ekonomike dhe embargot:

Përveç dispozitave të mëposhtme siç janë detajuar në seksionet 1 deri 7 më poshtë, Furnitori i kontrollon sanksionet dhe embargot potenciale të zbatueshme (veçanërisht, por pa u kufizuar në ligjet dhe rregulloret e Bashkimit Evropian dhe çdo Autoriteti Evropian (p.sh. Autoriteti Bankar Evropian, Banka Qendrore Evropiane, Bordi i Vetëm për Përmbyllje (SRB)) dhe shmang çdo gjë në lidhje me marrëdhëniet biznesore me Grupin RBI që përfundimisht mund të rezultojë në shkelje të sanksioneve ose embargove nga Grupi RBI.

2. Parimet themelore

Furnitori i respekton objektivat ndërkombëtarë klimatikë, siç përcaktohen në Konferencën e KB për Ndryshimet Klimatike në Paris (COP21), të drejtat e njeriut të proklamuar ndërkombëtarisht dhe shmangë bashkëpunimin në abuzimet e të drejtave të njeriut të çfarëdo lloji. Furnitori respekton dinjitetin personal, privatësinë dhe të drejtat e secilit individ. Puna e detyruar në të gjitha format është e ndaluar. Për më tepër, Furnitori i përmbahet të gjitha standardeve të hartuara nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO).

3. Praktikrat e përgjegjesisë sociale

3.1 Liria e asociimit dhe e drejta për negociata kolektive

Furnitori synon t'i zbatojë standardet e njohura ndërkombëtarisht pa shkelur legjislacionin kombëtar. Ai siguron që punëtorët dhe përfaqësuesit e tij, përfshirë punëtorët e përkohshëm (të agjencisë), mund ta shprehin hapur veten në kompaninë e tyre në lidhje me çështjet që lidhen me kushtet e tyre të punës.

3.2 Puna e fëmijëve

Puna e fëmijëve, siç përkufizohet nga ILO-IPEC dhe neni 32 i Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (UNCRC), është rreptësisht e ndaluar.

Nëse ndonjë fëmijë gjendet duke punuar në ambientet e Furnitorit, Furnitori menjëherë ndërmerr hapa për ta korrigjuar situatën në përputhje me interesat më të mira të fëmijës.

3.3 Diversiteti dhe mosdiskriminimi

Furnitori ndalon dhe lufton diskriminimin negativ bazuar në moshën, përkatësinë etnike, racën ose ngjyrën, origjinën kombëtare, religjionin ose besimin, mendimin politik ose mendimin tjetër, gjininë, orientimin seksual ose paaftësinë e personit, dhe e promovon diversitetin, barazinë e mundësive ose trajtimin në punësim dhe profesion. Furnitori i trajton të gjithë punëtorët me respekt dhe nuk përdorë ndëshkimin fizik, detyrimin mendor ose fizik, apo çdo formë abuzimi ose ngacmimi ose kërcënimi për një trajtim të tillë.

3.4 Kompensimi

Furnitori siguron kompensimin sipas standardit ligjor kombëtar për pagën minimale dhe shmangë çdo zbritje nga paga si masë disiplinore. Kur nuk ekzistojnë standarde ligjore kombëtare, kompensimi është i mjaftueshëm për t'i përmbushur nevojat themelore (ILO C131)- Konventa për Fiksimin e Pagës minimale).

3.5 Orari i punës

Orari i punës, përfshirë punën jashtë orarit, duhet të jenë në përputhje me ligjet vendore në fuqi. Kur nuk ekzistojnë standarde ligjore kombëtare, atëherë zbatohen standardet e ILO-s.

3.6 Shëndeti dhe siguria në punë

Furnitori u siguron punëtorëve të tij një vend pune të sigurt dhe të shëndetshëm dhe duhet të zbatojë programe efektive për ta - aty ku është e nevojshme - përmirësuar mjedisin e punës. Furnitori bën çmos për t'i kontrolluar rreziqet dhe për t'i marrë masat e nevojshme parandaluese kundër aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale. Furnitori inkurajohet të zbatojë një Sistem të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë bazuar në standardet ndërkombëtare, si OHSAS 18001 ose të ngjashme.

4. Praktikrat e përgjegjësisë mjedisore

4.1 Mbrojtja e mjedisit

Furnitori vepron në përputhje me standardet përkatëse vendore dhe ato të njohura ndërkombëtarisht për mjedisin dhe ligjet e zbatueshme vendore, ku zbatohet standardi më i lartë, veçanërisht duke përfshirë ROHS (Kufizimi i Substancave të Rrezikshme) dhe WEEE (Mbeturinat nga Pajisjet Elektrike dhe Elektronike). Furnitori e minimizon ndikimin e tij në mjedis dhe zbaton masa që kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit.

RBI pret që Furnitori t'i ndjekë rregullat e ekonomisë qarkulluese gjatë gjithë ciklit jetësor të produktit: konceptimi, zhvillimi, prodhimi, transporti, përdorimi dhe asgjësimi dhe/ose riciklimi. Furnitori minimizon ose përpiqet t'i shmangë emetimet e rrezikshme në ajër, konsumin e energjisë dhe emetimet e CO2. Në veçanti, Furnitori zhvillon produkte dhe shërbime që karakterizohen me konsum të ulët të energjisë dhe ulje të emetimit të CO2 gjatë gjithë ciklit jetësor.

4.2 Menaxhimi i mbeturinave dhe burimeve

Furnitori e kufizon përdorimin e materialeve dhe burimeve kur siguron ose prodhon mallra në mënyrë që të minimizojë ndikimin e tij në mjedis.

Furnitori inkurajohet ta gjurmtojë burimin e mineraleve të konfliktit, ta promovojë transparencën përgjatë zinxhirit të vet të furnizimit dhe të vendosë masa për këtë qëllim. Përdorimi i burimeve të rralla kufizohet ose shmangët kur është e mundur. Mbeturinat, të cilat janë prodhuar nga të gjitha aktivitetet e tij, identifikohen, monitorohen dhe menaxhohen. Furnitori përpiqet t'i zvogëlojë mbeturinat. Trajtimi i mbeturinave është në përputhje me ligjet në fuqi për mjedisin.

5. Integriteti i biznesit

5.1 Parimet kundër korrupsionit dhe krimit financiar

Furnitori përmbahet nga çdo formë e korrupsionit ose veprimeve të krimit financiar që mund të interpretohen si të tilla. Furnitori është i vetëdijshëm për çdo ligj të aplikueshëm (veçanërisht, por pa u kufizuar në Aktin e SHBA-së për Praktikrat e Huaja të Korrupsionit, Aktin e MB për Ryshfetin) dhe të shmangë çdo gjë në lidhje me marrëdhëniet biznesore me Grupin RBI që përfundimisht mund të rezultojë në shkelje të ligjit nga Grupi RBI.

Çdo konflikt i mundshëm ose ekzistues i interesit (p.sh. marrëdhënie e ngushtë, punë plotësuese) midis furnitorit/punëtorëve të furnitorit dhe RBI-së duhet t'i shpalojë menjëherë RBI-së përmes kanaleve të krijuara të komunikimit.

Furnitori nuk mund t'i ofrojë, premtojë ose japë përfitime të paligjshme zyrtarëve publikë kombëtarë ose ndërkombëtarë ose vendimmarrësve që veprojnë në sektorin privat, duke përfshirë por pa u kufizuar në përfaqësuesit e bankës, për të arritur një trajtim preferencial ose vendim të favorshëm; e njëjta gjë vlen kur është fjala për donacione, dhurata ose ftesa për dreka/darka dhe ngjarje afariste.

Furnitori nuk lejon që t'i premtohen ose ofrohen avantazhe dhe nuk i pranon të njëjtat nëse kjo mund t'i krijojë ose i krijon përshtypje palës që po i jep avantazhet, që në këtë mënyrë të mund të ndikohet në vendimet biznesore. Po kështu, Furnitori nuk mund të kërkojë avantazhe.

Në mënyrë që të sigurojë respektimin e Kodit për kohëzgjatjen e kontratës, furnitori i siguron RBI-së, sipas kërkesës dhe në çdo kohë, të gjithë elementët e kërkuar për ta arritur respektimin e këtij Kodi dhe e informon RBI-në, pa vonesë, kur është në dijeni ose ka arsye të dijë, për çfarëdo mosrespektimi të rregullave nga vetë ai ose ndonjë palë e tretë, si dhe për masat korrigjuese të miratuara për të siguruar respektimin e rregullave.

Mospërputhja materiale me Rregullat mund ta inicojë të drejtën e ndërprerjes së Kontratës në përputhje me dispozitat e saj.

5.2 Parimi i konkurrencës së lirë

Furnitori i respekton rregullat e konkurrencës së lirë dhe të ndershme në të gjitha marrëdhëniet biznesore, në veçanti nuk vepron në kundërshtim me çfarëdo ligji të konkurrencës dhe/ose antitrust. Furnitori nuk merr pjesë në ndonjë sjellje të fshehtë, nuk shkëmben ose zbulon ndonjë informacion me ndonjë palë të tretë në lidhje me ndonjë prokurim të planifikuar, në progres ose në pritje të Grupit RBI.

5.3 Parimi i sponsorizimit

Të gjitha masat e sponsorizimit nga Furnitori duhet të jenë në përputhje me legjislacionin vendor (kombëtar) në fuqi.

5.4 Parimi i kontributeve politike

Furnitori dhuron para ose jep ndonjë përfitim monetar për ndonjë parti politike vetëm siç rregullohet me ligjin vendor (kombëtar) dhe në përputhje me ligjin vendor (kombëtar).

5.5 Parimi kundër pastrimit të parave dhe kundër financimit të terrorizmit

Raiffeisen Bank International është e angazhuar që të veprojë plotësisht në përputhje me të gjitha direktivat e zbatueshme të BE-së dhe legjislacionin vendor (kombëtar). Ne refuzojmë të bëjmë biznes në mënyrën që e ndihmon ose lehtëson evazionin fiskal nga furnitorët tanë ose palët e tjera të treta. Ne i konsiderojmë furnitorët tanë si një shtyllë të rëndësishme në parandalimin e pastrimit të parave dhe në përpjekjet kundër financimit të terrorizmit dhe presim që furnitori t'i ndërmarrë të gjitha masat për ta parandaluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit brenda sferës së tij të ndikimit. Për furnitorët që detyrohen me ligj për zbatimin e politikave dhe procedurave të tilla, furnitori e bën këtë plotësisht dhe iu përmbahet ligjeve të tilla të ndryshuara herë pas here.

5.6 Prona intelektuale, siguria e të dhënave dhe mbrojtja e të dhënave

Furnitori vepron në përputhje me marrëveshjen e moszbulimit (ose të ngjashme) të lidhur me anëtarët e Grupit RBI dhe i përmbahet të gjitha ligjeve të zbatueshme të pronësisë intelektuale dhe mbrojtjes së të dhënave dhe të gjitha kërkesave specifike të mbrojtjes së të dhënave dhe sigurisë për të cilat është rënë dakord në Kontratë.

6. Nënkontraktimi

Furnitori i bën të gjitha përpjekjet për t'i obliguar kontraktorët dhe/ose nënkontraktorët e vet (në tekstin e mëtejme "nënkontraktorët") që t'i respektojnë parimet e këtij KiM për aq kohë sa ata janë të përfshirë në mënyrë të konsiderueshme në ofrimin e mallrave që duhet të dorëzohen sipas Kontratës. Furnitori i bën të gjitha përpjekjet për t'u përmbajtur nga përdorimi i paarsyeshëm i nënkontraktorëve ose ndonjë pale të tretë për shërbimet sipas Kontratës për t'i shmangur kërkesat e aplikueshme ligjore dhe ndonjë nga standardet e vendosura në KiM.

Furnitori siguron që furnitorët e tij të marrin përsipër ta:

- promovojnë dhe sigurojnë respektimin e parimeve të këtij KiM-i nga furnitorët dhe nënkontraktorët e tyre
- zbatojnë një sistem monitorimi që u mundëson atyre ta parandalojnë dhe trajtojnë çdo rrezik që ka ndikim mjedisor dhe/ose social në të gjithë zinxhirin e furnizimit.

7. Pajtueshmëria, monitorimi dhe auditimet

Rekomandohet që furnitori t'i japë personit përgjegjës mandatin dhe resurset e nevojshme për t'i zbatuar dhe respektuar dispozitat e këtij KiM (përfshirë, p.sh. sigurimin që punonjësit e tij e kuptojnë dhe i respektojnë këto standarde dhe monitorimin e rregullt të operimit të tij për ta siguruar përputhjen me Kodin).

RBI (gjegjësisht pala kontraktuale e drejtpërdrejtë e furnitorit) mund ta auditojë pajtueshmërinë e furnitorit dhe në disa raste të nënkontraktorit me KiM dhe informacionin e dhënë nga Furnitori. Nëse furnitori ose nënkontraktorët e shkelin KiM, RBI (gjegjësisht pala kontraktuale e drejtpërdrejtë e furnitorit) inicon një dialog dhe ka të drejtë të kërkojë një plan zbatimi për përmirësime që do ta sjellin furnitorin dhe/ose nënkontraktorin përsëri në pajtueshmëri të plotë me KiM.

Mospajtueshmëria materiale me parimet e Kodit nga furnitori mund të inicojë të drejtën e ndërprerjes së Kontratës në përputhje me dispozitat e saj, të iniciuara nga pala kontraktuale e drejtpërdrejtë e Furnitorit.

Furnitori është i vetmi përgjegjës për çdo shpenzim të bërë për të qenë në pajtueshmëri me KiM.

Furnitori duhet të raportojë në mënyrë proaktive te Departamenti i Prokurimit i RBI (përkatësisht te pala kontraktuale e drejtpërdrejtë e furnitorit) çdo devijim nga Kodi.

Furnitori ka të drejtë të përdorë linjën telefonike të sinjalizuesit të Grupit RBI <https://rbi.whispli.com/whistleblowing> ose të dërgojë email në compliance-gwb@rbinternational.com ose RBKO-Whistleblowing@raiffeisen-kosovo.com.